

TIMSS 2007 – KLASA E 4

DETYRA TË PUBLIKUARA (RELEASED ITEMS)

DETYRAT E PËRFSHIRA NË KËTË DOKUMENT JANË DETYRA TË PËRKTHYERA, TË MARRA SI DETYRA TË PUBLIKUARA NGA INTERNET FAQJA E *INTERNATIONAL ASSOCIATION FOR THE EVALUATION OF EDUCATIONAL ACHIEVEMENT* (IEA), <https://timssandpirls.bc.edu/TIMSS2007/items.html>, TË DREJTAT AUTORIALE TË SË CILAVE JANË TË MBROJTURA.

DETYRAT NUK GUXOJNË TË PËRDOREN PËR QËLLIME KOMERCIALE:

DETYRAT E PËRKTHYERA PUBLIKOHEN ME QËLLIM QË STUDENTËT E FAKULTETEVE PEDAGOGJIKE, SI DHE TË GJITHË PERSONAT E INTERESUAR (NXËNËS, PRINDËR DHE MËSIMDHËNËS) TË NJOFTOHEN ME DETYRAT TË CILAT JANË PJESË PËRBËRËSE E STUDIMIT TIMSS (TRENDS IN INTERNATIONAL SCIENCE AND MATHEMATICS STUDY)

Përkthimin dhe përshtatjen nga gjuha angleze është bërë nga prof. dr. Slagjana Jakimoviq, profesor i lëndës së matematikës në Fakultetin Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup.

Në gjuhë shqipe përkthimin e bëri prof. dr. Lulzim Ademi, profesor i gjuhës në Fakultetin Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup.

Kërkojmë ndjesë për gabimet e mundshme teknike dhe materiale.

Detyra 1. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**)Niveli njohës: **Njohuri**)

Në parkun e veturave, 762 vetura ishin parkuar në 6 radhë të barabarta. Sa automobil ka në secilën radhë?

Përgjigje: _____

Detyra 2. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**)Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

$$\begin{array}{r} 9 \quad 4 \quad 2 \\ - \quad 5 \quad \blacksquare \quad 7 \\ \hline 4 \quad 1 \quad 5 \end{array}$$

Blerimi i ka zgjedhur detyrat e shtëpisë me zbritje, por mbi ato kishte derdhur pijen. Njëra nga shifrat nuk mund të lexohet: Përgjigjja e tij 415 është e saktë. Cila është shifra e cila nuk shihet?





Përgjigje: _____


Detyra 3. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**)Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Vitin e kaluar në shkollë ka pasur 92 djem dhe 83 vajza. Këtë vit në shkollë ka 210 nxënës dhe 97 djem. Sa vajza më shumë ka këtë vit në raport me vitin e kaluar? Trego si e bën zgjidhjen.

Përgjigje: _____

Detyra 4. (Fusha: **Numra dhe operacione**)Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

	<u>Rregulla e Artës</u>	<input type="text" value="9"/>
	<u>Rregulla e Artës</u>	<input type="text" value="11"/>
	<u>Rregulla e Artës</u>	<input type="text" value="17"/>
	<u>Rregulla e Artës</u>	<input type="text" value="23"/>

Arta e ka përdorur rregullën e njëjtë që ta fiton numrin në nga numri në .

Cila ka qenë rregulla?

Përgjigje: _____

Detyra 5. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**)Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Temperatura në orën 7 në mëngjes ka qenë 12°C. Ajo është rritur për 2°C çdo orë derisa arriti 20°C në orën 11 paradite. Sa ishte temperatura në orën 9 paradite?

- A. 14°C
- B. 15°C
- C. 16°C
- Ç. 17°C

Detyra 6. (Fusha: **Numrat dhe operacionet** Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Petriti, Luljeta dhe Rina ecin në këmbë nga shkolla deri në shtëpi. U nevojiten 25 minuta të arrijnë deri te shtëpia e Rinës. Pastaj Petritit dhe Luljetës u duhen 10 minuta të arrijnë deri te shtëpia e Luljetës. Prej aty Petritit i duhen edhe 5 minuta ecje në këmbë deri në shtëpi.

Kur janë nisur së bashku nga shkolla nëse Petriti në shtëpi ka arritur në orën 15:50?

Përgjigje: _____

Detyra 7. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Një shishe në vete përmban 1 litër ujë. Agimi mbush 250 mililitra në gotë. Sa ujë ngel në shishe?

Përgjigje: _____ mililitra.

Detyra 8. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**

Niveli njohës: **Zbatim**)


Edoni do të zbulojë sa është pesha e një mace. Ai është matur dhe ka vërejtur se peshorja tregon 57kg. Ai pastaj përsëri është peshuar por duke mbajtur macen e tij në duar dhe ka parë se peshorja tregon 62kg. Sa është pesha e maces në kilogram?

Përgjigje: _____ kilogram.

Detyra 9. (Fusha: **Format gjeometrike dhe matje**)


Nivel njohës: **Njohuri**)

Katrori është prerë në 7 pjesë: Vendos X në secilin nga dy trekëndëshat të cilët janë me formë dhe madhësi të njëjtë.



Detyra 10. (Fusha: **Puna me të dhëna**)

Niveli njohës: **Zbatim**)



Jona ka kërkuar nga shokët e klasës që në letër t'i shënojnë sa vëllezër dhe motra ka secili nga ata. Ajo i ka mbledhur përgjigjet e tyre dhe ka filluar të bëjë tabelë me viza. Dy viza ka vendosur për fletët me zero:





Përfundo tabelën e Jonës.

Numri i vëllezërve dhe motrave	Viza
0	//
1	
2	
3	
4	

Detyra 11. (Fusha: **Puna me të dhëna**Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Lloji i drurit	Numri i drunjve
Pishë	200
Bredh	100
Lis	50
Mështekën	50

Në tabelë janë dhënë katër lloje të drunjve që rriten në park. Në cilën nga “petat” vijuese (grafik rrethor) në mënyrë të drejtë janë prezantuar informatat nga tabela?


**Detyra 12.** (Fusha: **Numra dhe operatione**Niveli njohës: **Njohuri**)

Në cilin nga vargjet vijuese, numrat janë radhitur nga MË I MADHI deri te MË I VOGLI?

- A. 36, 43, 66, 87
- B. 66, 43, 36, 87
- C. 87, 66, 36, 43
- Ç. 87, 66, 43, 36

Detyra 13. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)



Në një tavolinë mund të ulen 4 fëmijë: Në cilën mënyrë mund të gjesh sa tavolina nevojiten që të ulen 28 fëmijë??

- A. Shumëzo 28 me 4.
- B. Pjesëto 28 me 4.
- C. Zbrit 4 nga 28.
- Ç. Shto 4 në 28.

Detyra 14. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Njohuri**)

Shumëzo: $53 \cdot 26$


Përgjigje: _____

Detyra 15. (Fusha: **Numra dhe operacione**)

Niveli njohës: **Njohuri**)

E sata pjesë e kënddrejtit është e hijesuar?

- A. $\frac{1}{4}$
- B. $\frac{1}{3}$
- C. $\frac{6}{12}$
- Ç. $\frac{2}{3}$



Detyra 16. (Fusha: **Numra dhe operacione**)


Niveli njohës: **Zbatim**)

Rroni ka 10 zede (lloj i të hollave). Për drekë, ai blen një shishe me lëng pemësh që kushton 2,50 zede dhe sandviç për 3,85 zede. Edhe sa zede i kanë ngelur Rronit pasi e pagoi drekën e tij?

- A. 3,65 zede
- B. 4,75 zede
- C. 6,35 zede
- Ç. 16,35 zede

Detyra 17. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Zbatim**)



Cili është perimetri i këtij kënddrejti?

- A. 7 cm
- B. 10 cm
- C. 20 cm
- Ç. 21 cm

PLLAKA GJEOMETRIKE

UDHËZIM:

Për këtë detyrë të nevojitet karton në të cilin janë vizatuar 6 pllaka siç janë treguar më poshtë. Pllakat duhet të prehen nga kartoni.

4 pllaka trekëndore:



2 pllaka trapeze:




Këto pllaka mund të përdoren që të bëhen figura të reja: Një detyrë tashmë është zgjidhur:

PËRDOR: 3 pllaka trekëndore

KRIJO: Trapez

TREGO: Vizato në rrjetë.



Tani përpiqu t'i zgjedhësh detyrat vijuese.


Detyra 18. A. (Fusha: **Gjeometri dhe matje** Niveli njohës: **Zbatim**)

PËRDOR: 1 pllakë trekëndore dhe

1 pllakë trapez

KRIJO: Figurë katër këndore

TREGO: Vizato në rrjetë.




Detyra 18. B. (Fusha: **Gjeometri dhe matje** Niveli njohës: **Zbatim**)

PËRDOR: 2 pllaka trapez

KRIJO: Figurë gjashtëkëndore

TREGO: Vizato në rrjetë.




Detyra 18 C. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

PËRDOR: 2 pllaka trapez

KRIJO: Figurë gjashtëkëndore e cila nuk është me formë të njëjtë si në B.

TREGO: Vizato në rrjetë.



Detyra 18 Ç. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**


Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

PËRDOR: 2 pllaka trekëndore dhe

1 pllakë trapez


KRIJO: Figurë shtatë këndore

TREGO: Vizato në rrjetë.







Detyra 19. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Zbatim**)



Nëse figura lartë kthehet për 90° në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës. Cila formë fitohet?




Detyra 20. (Fusha: **Puna me të dhëna**)

Niveli njohës: **Zbatim**)

Çikriku mund të ndalet në 3 pozicione të ndryshme.


Këto janë rezultatet pas 100 rrotullimeve.



Rezultate pas 100 rrotullimeve:

E kuqe	50
E kaltër	30
E gjelbër	20

Merita filloi të vizatojë diagramin që t'i tregojë rezultatet. Ndhmoi Meritës ashtu që do t'i shënosh numrat e saktë në katrorët që ta kompletosh shkallën (boshtin vertikal). Јована започнала да црта дијаграм за да ги прикаже резултатите. Помогни и на Јована така што ќе ги напишеш точните броеви во квадратчињата за да ја комплетираш скалата (вертикалната оска).




Detyra 21. (Fusha: **Puna me të dhëna**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Ky diagram i tregon pikët e fituara nga ana e 4 vozitësve gjatë një gare në shpejtësi. Montoja është në vend të parë. Alonso është në vend të tretë. Vizato shtyllë e cila tregon sa pikë i ka fituar Alonso.

Pikët e fituara



Detyra 22. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Një grup prej 8 fëmijëve së bashku kanë 74 ëmbëlsira. Edhe sa ëmbëlsira u nevojiten që të mund t'i ndajnë në mënyrë të barabartë për çdo fëmijë?

Përgjigje: _____

Detyra 23. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Dy djem kanë shkuar të vrapojnë. Në çdo 2 km që i kanë vrapuar Rilindi, Altini ka vrapuar 3 km.

Rilindi gjithsej ka vrapuar gjithsej 6 km. Sa larg ka vrapuar Altini?

Përgjigje: _____ km

Detyra 24. (Fusha: **Puna me të dhëna**Niveli njohës: **Zbatim**)

Sara e ka matur largësinë e tabelës duke përdorur vizoren e gjatë 30cm. Tabela ishte 6cm më e shkurtër se 9 herë gjatësia e vizores. Sa është gjatësia e tabelës?

- A. 264 cm
- B. 270 cm
- C. 276 cm
- Ç. 279 cm

Detyra 25. (Fusha: **Numra dhe operacione**Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Anjeza e përdor rregullën që ta fiton numrin e saj nga numri i Dritanit, siç është treguar në tabelë.

Numri i Dritanit	Numri i Anjezës
1	3
2	6
4	12
6	18

Cilën rregull e përdor Anjeza që t'i fitojë numrin e saj?

Përgjigje: _____

Detyra 26. (Fusha: **Numra dhe operacione**Niveli njohës: **Zbatim**)

2, 5, 11, 23, ...

Duke e filluar vargun me numrin 2, me cilën nga rregullat vijuese do ta fitosh secilin nga anëtarët vijues në vargun më lartë?

- A. Shto 1 në anëtarin paraprak dhe pastaj shumëzo me 2.
- B. Shumëzo anëtarin paraprak me 3 e pastaj zbrit 1.
- C. Shumëzo anëtarin paraprak me 2 e pastaj shto 1.
- Ç. Zbrit 1 nga anëtari paraprak dhe pastaj shumëzo me 3.

Detyra 27. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)


$$64 : \square = \square$$

Në këtë shprehje numerike, \square shënon një numër të njëjtë. Në vend të cilit numër qëndron \square ?


- A. 4
- B. 8
- C. 16
- Ç. 32

Detyra 28. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**

Niveli njohës: **Zbatim**)



Sa pllaka trekëndore si kjo nevojiten të mbulohet figura e më poshtme?



Përgjigje: _____


Detyra 29. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Zbatim**)

Për këtë detyrë të nevojitet vizore. Përdore hartën e më poshtme dhe vizoren që të përgjigjesh në pyetjet vijuese (të parashtruara në faqen vijuese).

Qyteti i lumtur është qytet i ri. Qytetarët e Qytetit të lumtur bëjnë plan për qytetin e tyre të ri. Ata kanë vendosur ta vënë kuvendin e qytetit në gjysmë të rrugës mes liqenit dhe pyllit, siç është treguar në hartën më poshtë. Ata i bëjnë matjet e tyre nga pikat që janë të shënuara me X.

Qyteti i lumtur



Shto park, bibliotekë dhe shkollë në hartën e Qytetit të lumtur duke i përdorur informatat vijuese.

A. **Parku** duhet të jetë larg liqenit për 200m që njerëzit të mund të shkojnë për peshkim dhe për not. Në hartë me X shëno vendin ku do ta vendosësh parkun dhe nën shenjën X shëno **Park**.


B. **Biblioteka** duhet të jetë së paku 300m, e jo më shumë se 400m e larguar nga Kuvendi i qytetit. Në hartë shëno me X vendin ku do ta vendosësh bibliotekën dhe nën shenjën X shëno **Bibliotekë**.

C. **Shkolla** duhet të jetë në gjysmë të rrugës mes parkut dhe bibliotekës. Në hartë shëno me X vendin ku do ta vendosësh shkollën dhe nën shenjën X shëno **Shkollë**.

Detyra 30. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Zbatim**)

Në rrjetin më poshtë, vizato figurë që është simetrike në bosht me figurën e dhënë në raport me boshtin e simetrisë të shënuar me vijën e ndërprerë.



Detyra 31. (Fusha: **Puna me të dhëna**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Në par ka pasur 5 fëmijë: Disa kanë mbajtur kapele, kurse disa nuk kanë mbajtur.

Vajza	DjemМомчиња
Merita ka mbajtur kapele.	Visari ka mbajtur kapele.
Arita nuk ka mbajtur kapele.	Bujari nuk ka mbajtur kapele.
Anisa nuk ka mbajtur kapele.	

Plotëso tabelën që ta tregosh numrin e djemve dhe numrin e vajzave që kanë mbajtur dhe që nuk kanë mbajtur kapele.

	Me kapele	Pa kapele
Djem		
Vajza		

Detyra 32. (Fusha: **Numra dhe operacione**


Niveli njohës: **Njohuri**)

Cili numër është i barabartë me 3 njëshe + 2 dhjetëshe + 4 qindëshe?

- A. 432
- B. 423
- C. 324
- Ç. 234

Detyra 33. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Njohuri**)



Këto janë 12 ëmbëlsira. Vizato vijë të mbyllur rreth $\frac{1}{3}$ të ëmbëlsirave.

Detyra 34. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Njohuri**)

Cila thyes është e barabartë me $-\frac{2}{3}$?

A. $\frac{3}{4}$

B. $\frac{4}{9}$

C. $\frac{4}{6}$

Ç. $\frac{3}{2}$

Detyra 35. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Njohuri**)

Genti ka shpenzuar $\frac{3}{10}$ e të hollave të tij për stilolaps dhe $\frac{5}{10}$ të të hollave për libër

Sa nga paratë e tij i ka shpenzuar Genti?

Përgjigje: _____

Detyra 36. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Besa ka 32 lapsa dhe 4 kuti për lapsa. Ajo ka vënë numë të njëjtë të lapsave në çdo kuti. Cila shprehje numerike paraqet sa lapsa Besa ka vënë në çdo kuti?

A. $32 + 4 = \square$

B. $32 - 4 = \square$


C. $32 \cdot 4 = \square$

Ç. $32 : 4 = \square$


Detyra 37. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Njohuri**)


Në cilat nga këto vizatime, vija e ndërprerë është bosht i simetrisë?



A.



B.



C.




Ç.

Detyra 38. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)


Niveli njohës: **Zbatim**)

Këto janë dy anë e një drejtkëndëshi. Vizato edhe anët tjera.



Detyra 39. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**

Niveli njohës: **Zbatim**)



Valdeti e ngjyros një rënë anë të gardhit. Gardhi është i gjatë 4m kurse i gjerë 3m. Sa është syprina që duhet të ngjyros Valdeti?


- A. 4 metra katror
- B. 7 metra katror
- C. 12 metra katror
- Ç. 14 metra katror

Detyra 40. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**


Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Më poshtë janë paraqitur dy forma. Përshkruaj në cilën mënyrë janë të njëjta dhe përshkruaj në cilën mënyrë janë të ndryshme

Forma P



Forma Q



- A. Të njëjtë

- B. Të ndryshme

Detyra 41. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)Niveli njohës: **Njohuri**)

Njeriu në foto është i lartë 2 metra.

Vlerëso lartësinë e drurit.

- A. 4 metra
- B. 6 metra
- C. 8 metra
- Ç. 10 metra


Detyra 42. (Fusha: **Puna me të dhëna**)Niveli njohës: **Zbatim**)

Disa nxënës kanë mbledhur informata për atë sa shpejt lëvizin automobilat përkaj shkollës së tyre. Tabela poshtë i tregon rezultatet për 20 automobila.

Automobili	Ngadalë	Mesatarisht	Shpejt
1		X	
2	X		
3	X		
4			X
5			X
6	X		
7		X	
8		X	
9	X		
10	X		
11	X		
12		X	
13	X		
14			X
15			X
16	X		
17		X	
18	X		
19		X	
20			X

Që rezultatet të jenë më të lehtë për lexim, nxënësit kanë filluar t'i paraqesin informatat me anë të diagramit në formë të shtyllës.

Përfundoni diagramin.



Detyra 43. (Fusha: **Puna me të dhëna**)

Niveli njohës: **Njohuri**)

Piktogrami i tregon numrin e mollëve të cilat Fatmiri i mbledh çdo ditë. Çdo paraqet 10 mollë.



E hënë	
E martë	
E mërkurë	
E enjte	

Cilën ditë Fatmiri mbledhi 5 mollë?


- A. Të hënë B. Të martën C. Të mërkurën Ç. Të enjten

Detyra 44. (Fusha: **Puna me të dhëna**)


Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Në klasat A dhe B ka nga 40 nxënës.

Klasa A



Klasa B



A ka më shumë vajza në klasën A sesa në klasën B. Për sa janë më shumë?

- A. 14
B. 16
C. 24
Ç. 30

Detyra 45. (Fusha: **Numra dhe operacione** Niveli njohës: **Zbatim**)

Ka 9 radhë të karrigeve. Në çdo radhë ka nga 15 karrige. Cila nga shprehjet në vijim e tregon numrin gjithsej të karrigeve?

- A. $15 : 9$
- B. $15 - 9$
- C. $15 \cdot 9$
- Ç. $15 + 9$

Detyra 46. (Fusha: **Numrat dhe operacionet** Niveli njohës: **Zbatim**)

Një pjesë e litarit, e cila është gjatë 204cm, është e prerë në 4 pjesë të barabarta. Cila është gjatësia e secilës pjesë?

Përgjigje: _____ cm.

Detyra 47. (Fusha: **Numrat dhe operacionet** Niveli njohës: **Zbatim**)

$$12 : 3 = \square : 2$$

Në këtë barazim të numrave, në vend të cilit numër qëndron \square ?

- A. 2
- B. 4
- C. 6
- Ç. 8

Detyra 48. (Fusha: **Numrat dhe operacionet**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Posteret e dy klubeve sportive të cilët japin biçikleta me qira janë paraqitur më poshtë.

Dhënie me qira të biçikletave malore

8 zede për orën e parë

3 zede për çdo orë të ardhshme



Dhënie me qira të biçikletave garuese

10 zede për orën e parë

2 zede për çdo orë të ardhshme



A. Përdori informatat nga postaret që t'i plotësosh tabelat.

Dhënie me qira të biçikletave malore	
Orë	Çmimi (zede)
1	8
2	11
3	
4	
5	
6	

Dhënie me qira të biçikletave garuese	
Orë	Çmimi (zede)
1	10
2	12
3	
4	
5	
6	

B. Për sa orë marrje me qira çmimet janë të njëjta në të dy klubet?

Përgjigje: _____

C. Në cilin klub është më lirë të merret me qira biçikletë për 12 orë?

- a. Dhënie me qira të biçikletave malore
- b. Dhënie me qira të biçikletave garuese
- c. E njëjtë për të dy klubet
- ç. Nuk mund të përcaktohet

Detyra 49. (Fusha: **Numra dhe operacione** Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)


Një njeri i shpuri tre fëmijët e tij na panair. Bileta për të rritur është dy herë më e shtrenjtë sesa bileta për fëmijë. Babai gjithsej pagoi 50 zede për 4 biletat.

Sa zede kushtuan secili nga biletat e fëmijëve? Shkruaj zgjidhjen në tërësi.


Përgjigje: _____

Detyra 50. (Fusha: **Gjeometri dhe matje** Niveli njohës: **Njohuri**)

Ardiana ka një copë letre në formë drejtkëndëshi.



Ajo e ka prerë letrën për gjatë vijës së ndërprerë dhe e ka bërë formën si më poshtë.



Cili nga pohimet vijuese është i saktë?

- A. Syprina e figurës së re është më e madhe nga syprina e drejtkëndëshit.
- B. Syprina e figurës së re është e barabartë me syprinën e drejtkëndëshit.
- C. Syprina e figurës së re është më e vogël se syprina e drejtkëndëshit.
- Ç. Nuk mund të përcaktohet cila syprinë është më e madhe pa u bërë matje.

Detyrë 51. (Fusha: **Numra dhe operacione** Niveli njohës: **Zbatim**)

Jehona ka 6 kuti të kuqe. Në çdo kuti të kuqe ka 4 lapsa. Jehona ka edhe 3 kuti të kaltra. Në çdo kuti të kaltër ka 2 lapsa. Sa lapsa gjithsej ka Jehona?

- A. 6 B. 15 C. 24 Ç. 30

Detyrë 52. (Fusha: **Gjeometri dhe matje** Niveli njohës: **Njohuri**)









Figura lartë është e bërë nga drejtkëndësh dhe nga trekëndësh me tre anë të njëjta. Cila është gjatësia në centimetra e anës AC?

- A. 8 B. 9 C. 10 Ç. 11

Detyrë 53. (Fusha: **Puna me të dhëna** Niveli njohës: **Zbatim**)

Rruga	Numri i shtëpive
Rruga kryesore	
Rruga qendrore	
Rruga e parë	
Rrugë kodrinore	

Adea bën pasqyrë të numrit të shtëpive në disa rrugë. Çdo  qëndron për 5 shtëpi.

Në rrugën kodrinore ka 20 shtëpi. Sa  duhet të vë Adea në fushën përskaj Rrugë kodrinore?

- A. 4 B. 5 C. 15 Ç. 20

Detyra 54. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)

$$\frac{4}{5} - \frac{1}{5} =$$

A. $\frac{3}{5}$

B. $\frac{3}{10}$

C. $\frac{3}{25}$

Ç. 3

Detyra 55. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)

$$12,36 - 9,7 =$$

Përgjigje: _____

Detyra 56. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Cili nga numrat vijues sipas madhësisë është më i afërt me numrin 10?

A. 0,10

B. 9,99

C. 10,10

Ç. 10,90

Detyra 57. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Zbatim**)

Katër numrat e parë të një vargu numëror janë treguar më poshtë. .

$$2, 4, 8, 16, \dots$$

Cili është numri i ardhshëm në varg?

A. 24

B. 30

C. 32

Ç. 64


Detyra 58. (Fusha: **Numra dhe operacione** Niveli njohës: **Zbatim**)

Një raft është i gjatë 240 cm. Artani vë kuti në raft. Çdo kuti zë 20 cm të gjatësisë së raftit.


Cila nga shprehjet numerike tregon sa kuti Artani mund të vë në raft? Numri i kutive është paraqitur me ▲.

- A. $240 - 20 = \blacktriangle$
- B. $240 : 20 = \blacktriangle$
- C. $240 + 20 = \blacktriangle$
- Ç. $240 \cdot 20 = \blacktriangle$


Detyra 59. (Fusha: **Gjeometri dhe matje** Niveli njohës: **Njohuri**)



Genci



Rina




Argjira

Genci, Rina dhe Argjira i radhisin pllakat njëra pas tjetrit. Secili ka radhitur pllakat në forma të ndryshme siç është treguar më lartë. Cili nga pohimet që vijojnë është i vërtetë për format?

- A. Forma e Gencit ka syprinë më të madhe se të tjerat.
- B. Forma e Rinës ka syprinë më të madhe se të tjerat.
- C. Forma e Argjirës ka syprinë më të madhe se të tjerat.
- Ç. Të gjithë format kanë syprinë të njëjtë.

Detyra 60. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Njohuri**)



Në shkallën matëse më lartë, cilën vlerë e tregon akrepi?

A. 302

B. 310

C. 320

Ç. 340

Detyra 61. (Fusha: **Numra dhe operacione**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduar**)

Fisniku do të pjek biskota. Ai së pari duhet ta nxehtë furrën 10 minuta, e pastaj t'i pjek biskotat 12 minuta/ Fisniku do të mbaroj me pjekjen e biskotave në orën 11:00. Kur më së voni duhet ta kthejë furrën që të nxehet?

A. 10:38

B. 10:48

C. 10:50

Ç. 11:22


Detyra 62. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**

Niveli njohës: **Njohuri**)

Drini ka shumë pllaka si kjo:



Bardhi ka shumë pllaka si kjo:



Krenari ka shumë pllaka si kjo:



Erioni ka shumë pllaka si kjo:



Cilit do t'i nevojiten më pak nga pllakat e tij që ta mbulojë dyshe-menë e klasës?

A. Drinit







B. Bardhit

C. Krenarit

Ç. Erionit

Detyra 63. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Njohuri**)




Shkruaj shkronjat e të gjitha formave të cilat janë trekëndësha.

Përgjigje: _____


Detyra 64. (Fusha: **Gjeometri dhe matje**)

Niveli njohës: **Zbatim**)




Cila nga figurat vijuese mund të thyhet që të fitohet 3D forma e treguar më lartë?


A.




B.



C.




Ç.



Detyra 65. (Fusha: **Puna me të dhëna**

Niveli njohës: **Arsyetim/Të menduarit**)



Trimja i pyetur 20 shokët e klasës së saj a e duan më shumë lëngun e mangos, portokallit ose ananasit. Ajo i ka treguar të dhënat në diagram në formë shtylle që mund ta shihni më lartë.

Ajo ka vizatuar edhe “petë” (grafik rrethor) duke i përdorur të njëjtat të dhëna. Cila nga petat vijuese i paraqet të dhënat e njëjta sikurse në diagramin në formë shtylle?

